

Rrjeta interaktive për arsim dhe resurse

Rini e mbrojtur dhe e sigurt. Net

Etika e Rrjetit - Netika (Net-Etiquette)


Etika e Rrjetit - Netika

Ndryshimet e përditshme të teknologjitë, mundësitë që i ofrojnë ato, përpara nesh hapin perspektiva të mëdha në çdo aspekt. Por mundësitë për komunikim duhet t'i shfrytëzojmë duke iu përmbajtur normave etike të sjelljes. Në kohë të sotme është aktual termi Etika e Rrjetit - Netika (net-etika ose etika e sjelljes gjatë shfrytëzimit të Internetit - Net-Etiquette). Kjo përcakton se si duhet të sillemi kur me ndihmën e mjeteve komunikuese njihemi me dikë, si të komunikojmë, zyrtarisht dhe privatisht, si të sillemi gjatë komunikimit kur jemi pjesë e grupit (email lista), si të sillemi gjatë shfletimit të informatave, si dhe si të përcaktojmë vlefshmërinë e të dhënave të gjetura, si t'i krahasojmë më tepër burime. Trajnimi për netika dhe zbatimi i saj në komunikimin e përditshëm tani më është shndërruar në nevojë, nëse duam që në mënyrë etike t'i shfrytëzojmë mundësitë e reja që i ofrojnë teknologjitë. Çdo trajnim, formal ose joformal, për shfrytëzimin e teknologjive të reja, nënkupton trajnim për shfrytëzim etik të këtyre teknologjive.

Përkatësisht, duke shfrytëzuar teknologjitë e reja, duhet të jemi shumë të kujdesshëm edhe në marrjen e të dhënave nga Interneti. Interneti nuk është pronë e dikujt dhe askush nuk mund t'i kontrollojë të dhënat që vendosen çdo minutë në të. Gjeneratat e reja dhe shfrytëzuesit e rinj të Internetit do të duhet të gjenden në detin e pafund të informata në Internet, të mos bien nën ndikimet e ndryshme, të mund t'i qasen në mënyrë kritike informatës së gjetur duke e krahasuar me burime të tjera.

Institucionet arsimore e zgjidhin këtë problem, me atë që realizojnë trajnime të arsimtarëve dhe nxënësve si në mënyrë kritike t'u qasen informatave të marra nga Interneti dhe t'i krahasojnë ato me burime të tjera. Disa institucione edhe vetë e kufizojnë qasjen e nxënësve të tyre në faqe të caktuara dhe jo të sigurta. Për shembull, në Kanada në nivel shtetëror është i kufizuar përdorimi i faqes www.yahoo.com në shkollë, meqë lidhja me këtë faqe llogaritet si lidhje jo e sigurt dhe informata të pakontrolluara mund të gjenden në të.

Etika elektronike nënkupton rregulla gjatë shfrytëzimit të teknologjisë kompjuterike dhe lidhjes në rrjet. Por, askush nuk mund të detyrojë dikë që t'i përmbahet kësaj etike, sidomos, për shkak se shfrytëzimi i kësaj teknologjie më së shpeshti e fsheh identitetin e shfrytëzuesit. Askush nuk mund të garantojë për atë që çdo ditë vendoset ose përcillet nëpërmjet Internetit. Për shkak të



Rrjeta interaktive për arsim dhe resurse

kësaj fillojnë të krijohen shoqata elektronike të njerëzve të cilët kujdesen për përmbajtjen e web faqeve të caktuara, duke i azhurnuar dhe kontrolluar të dhënat e vendosura në to.

Tani më etika në arsim e ndryshon fokusin drejt lirisë së informatave, drejt qasjes së lirë dhe softuerit të lirë. Kur flasim për etikën në shoqërinë elektronike duhet të bëjmë fjalë për etikën intelektuale. Pjesa më e madhe e informatave me ndihmën e teknologjive të reja na janë lehtësisht të arritshme. Kjo nuk do të thotë se lirisht mund të bëjmë plagjiat dhe të shfrytëzojmë punime të tjerëve, përkundrazi, etika e kohës së re na imponon citimin e autorit ose web faqes së gjetur në Internet, ta theksojmë autorin / web faqen dhe kohën se kur ajo dhënë është marrë.

E gjithë kjo nxit një zhvillim të mëtejshëm. E tërë kjo hap modele të reja ekonomike për punë dhe përfitim, modele dhe mundësi të reja arsimore. Shkollat duhet të parat ta përqafojnë këtë koncept, ta zbatojnë dhe t'i shfrytëzojnë mundësitë e shumta që i ofron ai, meqë qëllimi kryesor i shkollave është t'i edukojë të rinjtë të cilët do të bëhen qytetarë produktiv të shoqërisë bashkëkohore elektronike.

Pyetje të mundshme për diskutim:

- Përfundimisht në Internet mund të jemi ajo çfarë duam të jemi! Pa kufizime! A nevojiten rregulla për komunikim nëpërmjet Internetit? Cilat do të ishin ato rregulla?
- Shfrytëzimi i materialeve të autorëve të tjerë për nevoja personale nën emrin tonë personal a është e pranueshme? Si të përcaktohet nëse është e pranueshme dhe në çfarë mase do të pranohej shfrytëzimi i materialit nga autorë të huaj?
- Si mund t'i shfrytëzojmë të gjitha mundësitë që i kemi nëpërmjet Internetit për t'u zhvilluar dhe për të mësuar? A është i mundur të mësuarit me ndihmën e Internetit?
- Si ta dallojmë atë që kemi gjetur në Internet nëse është autentike dhe e saktë?